



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/2021 Ref.: 3015/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2026:
 - Gazetari, BA, 180 ECTS, maksimumi 150 studentë për vit akademik.
 - Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, BA, 240 ECTS, maksimumi 120 studentë për vit akademik.
 - Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 240 ECTS, maksimumi 120 studentë për vit akademik.
 - Gjuhë dhe Letërsi Frënge, BA, 240 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- II. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Gjuhë dhe Letërsi Turke, BA, 240 ECTS, maksimumi 35 studentë për vit akademik.
 - Orientalistikë, BA, 240 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
 - Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, MA, 60 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik.
- III. Akreditohen programet e studimit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Ballkanistikë, BA, 240 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
 - Gjuhë Angleze (Program i Integruar i Gjuhësisë), MA, 60 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik.
 - Letërsi Angleze, MA, 60 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik.

- Gjermanishtja si Gjuhë e Huaj, MA, 60 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik.

IV. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.

V. Obligohet Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" që deri më datë 15.11.2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1	Gazetari, BA, 180 ECTS Ri-akreditim	Remzije Shahini-Hoxhaj Gëzim Qerimi Muhamet Jahiri
2	Gjuhë dhe Letërsi gjermane, BA, 240 ECTS Ri-akreditim	Vjosa Hamiti Albulena Blakaj Gashi Sadije Rexhepi Naim Kryeziu
3	Gjuhë dhe Letërsi angleze, BA, 240 ECTS Ri-akreditim	Lendita Kryeziu Seniha Krasniqi Lirak Karjagdiu Bekim Bejta
4	Gjuhë dhe Letërsi frënge, BA, 240 ECTS Ri-akreditim	Valbona Berisha Avdi Visoka Nerimane Kamberi Lendita Gjikoçi
5	Gjuhë dhe Letërsi Turke, BA, 240 ECTS Ri-akreditim	Nuran Malta Ergin Jable Nebahat Sylçevci Salih Okumush
6	Orientalistikë, BA, 240 ECTS Ri-akreditim	Abdulla Hamiti Abdulla Rexhepi Isa Memishi Muhamet Çitaku
7	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, MA, 60 ECTS Ri-akreditim	Blertë Ismajli
8	Ballkanistikë, BA, 240 ECTS Akreditim	Zeqije Xhafqe Ardita Berisha Ana Sivački Josip Lasić

9	Gjuhë Angleze (Program i Integruar i Gjuhësisë), MA, 60 ECTS Akreditim	Lindita Tahiri
10	Letërsi Angleze, MA, 60 ECTS Akreditim	Muhamet Hamiti
11	Gjermanishtja si Gjuhë e Huaj, MA, 60 ECTS Akreditim	Milote Sadiku

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC

AKA ka organizuar tri vizita me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Filologjisë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 23.03.2021, 15.04.2021 dhe më 21.05.2021, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Majda Tafravlahović, Andrew Goodspeed, Frank Baasner, Juraj Bogat, Anida Kisi, Barbara Kerovec dhe Vjeran Kursar.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Gazetari, BA, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht katër (4), substancialisht tri (3).
2. Për programin e studimit Gjuhë dhe Letërsi gjermane, BA, 240 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht gjashtë (6), substancialisht një (1).
3. Për programin e studimit Gjuhë dhe Letërsi angleze, BA, 240 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht tri (3), i përmbush substancialisht tri (3) dhe e përmbush pjesërisht një (1).
4. Për programin e studimit Gjuhë dhe Letërsi frënge, BA, 240 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht gjashtë (6).
5. Për programin e studimit Gjuhë dhe Letërsi Turke, BA, 240 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht gjashtë (6), pjesërisht një (1).
6. Për programin e studimit Orientalistikë, BA, 240 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht pesë (5), substancialisht dy (2).
7. Për programin e studimit Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, MA, 60 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht shtatë (7).
8. Për programin e studimit Ballkanistikë, BA, 240 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2), substancialisht katër (4), pjesërisht një (1).
9. Gjuhë Angleze (Program i Integruar i Gjuhësisë), MA, 60 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht katër (4), pjesërisht dy (2).
10. Letërsi Angleze, MA, 60 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht pesë (5), substancialisht dy (2).
11. Gjermanishtja si Gjuhë e Huaj, MA, 60 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht gjashtë (6), substancialisht një (1).


Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07. 07. 2021 dhe 27.07.2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në

rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit të Filologjisë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

